



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Shkurt 2022

Nr: 90

VENDIM

PËR

**DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DY QENDRAVE
TË VOTIMIT NË BASHKINË SHKODËR, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE
TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, neneve 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 62, pika 4, nenit 93, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N:

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 (dyzet) ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 47, datë 7.2.2022, “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Durrës, Dibër, Vorë, Rrogozhinë, Lushnjë të datës 6 Mars 2022”, miratoi vendndodhjet e disa qendrave të votimit në ndërtesa private, bazuar në propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga kryetarët e bashkive.

Për QV nr. 0299 dhe QV nr. 0299/1, miratuar me vendimin sipërcituar, me vendndodhje në shkollën “ABC”, institucion arsimor privat, në KQZ është administruar kërkesa e bashkisë Shkodër me propozimin për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit nga shkolla “ABC” në



shkollën “Salo Halili”, institucion arsimor publik, duke referuar se vendndodhja e re e propozuar ndodhet me afër zgjedhësve si dhe ka infrastrukturë më të mirë zgjedhore për zgjedhësit PAK.

Gjithashtu, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 3, shpreh në mënyrë unanime nëpërmjet kërkesës së tij, drejtuar KQZ dhe bashkisë Shkodër, dakordësinë për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 3, të udhëzimit nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”,

V E N D O S I:

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 0299 dhe QV nr. 0299/1, nga shkolla “ABC”, në shkollën “Salo Halili”, bashkia Shkodër.
2. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të kryejë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e dy qendrave të votimit, të caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

